

V E N D I M
Nr.231, datë 21.8.2001

**PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË AGRARE TË SHQIPËRISË,
TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

OBJEKT:Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Agrare të Shqipërisë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

BAZA LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Agrare e Shqipërisë, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumëmemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.781, datë 2.6.2001 “Për rregjistrimin e listës shumëmemërore të Partisë Agrare të Shqipëri për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001”.

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Agrare e Shqipërisë ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 3 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumëmemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 3.

Partia Agrare e Shqipërisë, me shkresën nr.247/1 prot. datë 1.8.2001, ka vënë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për dorëheqjet që kanë dhënë nga kandidimi për deputet nga lista shumëmemërore 20 kandidatë të kësaj partie si më poshtë:

1. z.Edlir Petanaj
2. z. Ymer Tola
3. z. Ramazan Hasa
4. z. Pëllumb Abeshi
5. z. Resmi Osmani
6. z. Shahin Bejdaj
7. z. Fadil Kukaj
8. z. Muzafer Kraja
9. z.Zeqir Basha
10. z. Paqësor Cane
11. z. Petrit Gjoni
12. z. Vladimir Lleshaj
13. z. Arben Shytaj
14. z. Beqir Elezi
15. z. Vezir Metaj
16. z. Mylazim Tusku

17. z. Selim Kolushi
18. z. Pashk Aliaj
19. zj. Taire Bozhani
20. z. Kujtim Nanaj

Duke qenë se numri 1 dhe 3 i listës shumemërore nuk ndryshojnë, pas dorëheqjeve të paraqitura z. Refet Dervina, i cili ka numrin rendor 23, llogaritet i treti në listë shumemërore të kandidatëve për deputetë të kësaj partie.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë:

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Agrare të Shqipërisë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

1. z. Lufter Xhuveli
 2. z. Ndue Preka
 3. z. Refet Dervina
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gaspër Kokaj	Ilirjan Celibashi